

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI MASTER: I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME
SPECIALIZIM NË MATEMATIKË**



TEZA MASTER

**Analizë krahasuese ndërmjet suksesit të nxënësve në shkollë dhe
në testin e maturës shtetërore në lëndën e matematikës**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Xhevat Krasniqi

Kandidatja:

MAJLINDA AXHAMI

Prishtinë, [Shkurt, 2022]

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI MASTER: I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME
SPECIALIZIM NË MATEMATIKË**



TEZA MASTER

**Analizë krahasuese ndërmjet suksesit të nxënësve në shkollë dhe
në testin e maturës shtetërore në lëndën e matematikës**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Xhevat Krasniqi

Kandidatja:

Majlinda Axhami

Prishtinë, [Shkurt, 2022]

© 2021 - *Majlinda Axhami* Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj dallimin mes suksesit të nxënësve në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm dhe pikëve që ata marrin në provimin e maturës në matematikë. Kjo ka rëndësi në të nxënit e matematikës sepse sipas hulumtimeve bashkëkohore ka një ndikim reciprok mes vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm dhe qëllimi kryesor i këtyre dy formave të vlerësimit është për të përmirësuar arsimin matematikor. Pyetja që shtrohet është: Sa ndikon sukcesi që kanë nxënësit gjatë shkollimit të mesëm në lëndën e matematikës në pikët që ata marrin në provimin e maturës në matematikë? Në bazë të kësaj pyetje rrjedhë edhe hipoteza: Pikët që i arrijnë nxënësit në provimin e maturës në matematikë varen ekskluzivisht nga sukcesi në lëndën e matematikës të cilin e kanë gjatë shkollimit të mesëm. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur qasja sasiore, më saktësisht modeli jo-eksperimental korrelativ. Pjesë e studimit kanë qenë 339 maturantë të vitit 2021. Të dhëna janë mbledhur përmes regjistrave që gjenden në shkollat përkatëse dhe më pas është përdorur analiza deskriptive (përshkruese) dhe ajo inferenciale për të bërë interpretimi dhe për të gjetur përgjigjen e kërkuar. Rezultatet e këtij studimi kanë treguar që pikët e nxënësve në provimin e maturës në lëndën e matematikës në pjesë më të madhe të rasteve varen ekskluzivisht nga sukcesi që kanë në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm. Prandaj sa më shumë që të kontribuojmë që nxënësit të mësojnë me cilësi gjatë shkollimit të mesëm, atëherë sukcesi i tyre do të jetë më i mirë dhe rrjedhimisht rezultati i pikëve në testin e maturës do të jetë më i lartë.

Fjalët kyçe: *Matematikë, Nota, Pikët, Provimi i maturës.*

ABSTRACT

The purpose of this research is to analyze the difference between the success of students in the subject of mathematics during high school and the points they receive in the Matura exam in mathematics. This is important in learning mathematics because according to contemporary research there is a reciprocal impact between internal assessment and external assessment and the main purpose of these two forms of assessment is to improve mathematics education. The question that arises is: How much does the success that students have during high school in the subject of mathematics affect the points they receive in the Matura exam in mathematics? Based on this question, the hypothesis is derived: The points that students achieve in the Mathematics Matura exam depend exclusively on the success in the mathematics subject that they have during high school. The quantitative approach, more precisely the non-experimental correlative model, was used to conduct this research. Part of the study were 339 graduates of 2021. Data were collected through registers found in the respective schools and then descriptive and descriptive analysis was used to make the interpretation and find the required answer. The results of this study have shown that students' points in the Matura exam in the subject of mathematics in most cases depend exclusively on their success in the subject of mathematics during high school. Therefore, the more we contribute to the students to learn with quality during high school, then their success will be better and consequently the score of points in the Matura test will be higher.

Keywords: *Mathematics, Grade, Points, Matura Exam.*

DEDIKIMI

Dedikuar engjëllit tim në qiell dhe engjëllit tim në tokë.

FALËNDERIMI

Realizimi i këtij hulumtimi kërkoi mund dhe përkushtim të madh, prandaj do të ishte i pamundur të realizohej pa mbështetjen dhe përkrahjen e mentorit Prof. Asoc. Dr. Xhevat Krasniqi, të cilin dëshiroj ta falenderoj për punën e palodhur, inkurajimin dhe udhëzimet e vlefshme të cilat synonin ngritjen e nivelit të punimit.

Një falenderim i veçant shkon për anëtarët e komisionit Prof. Dr. Eda Vula dhe Prof. Asoc. Dr. Vjollca Ahmedi për shqyrtimin dhe miratimin e këtij hulumtimi, të gjithë profesorët e tjerë të cilët kontribuan me njohuritë e tyre gjatë gjithë kohës së studimeve, si dhe kolegët për bashkëpunimin gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu dëshiroj që të falenderoj Drejtorinë Komunale të Arsimit të komunës së Gjilanit dhe të gjitha shkollat e mesme të kësaj komune që më lejuan që të realizoj këtë hulumtim.

Falenderoj përzemërsisht familjen për mbështetjen morale, durimin dhe kurajon që më kanë dhënë gjithmonë.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| HYRJE | 3 |
| Qëllimi i hulumtimit..... | 5 |
| Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza | 5 |
| SHQYRTIMI I LITERATURËS | 6 |
| Qëllimi i vlerësimit..... | 6 |
| Llojet e vlerësimit..... | 7 |
| 1. Vlerësimi i brendshëm..... | 7 |
| 2. Vlerësimi i jashtëm..... | 8 |
| Ndikimi i vlerësimit të brendshëm në vlerësimin e jashtëm | 10 |
| Ndikimi i vlerësimit të jashtëm në vlerësimin e brendshëm | 12 |
| Ndërlidhja e vlerësimit në shkallë të gjerë dhe vlerësimit në klasë | 13 |
| METODOLOGJIA | 16 |
| Mostra..... | 16 |
| Instrumentet..... | 19 |
| Procedurat..... | 19 |
| ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET | 22 |
| Analiza e të dhënave totale..... | 22 |
| 1. Suksesi i mjaftueshëm: | 36 |
| 2. Suksesi i mirë: | 37 |

| | |
|--|----|
| 3. Suksesi i shkëlqyeshëm: | 38 |
| Analiza e të dhënave të ndarë sipas shkollave | 40 |
| 1. Gjinnazi i Shkencave Natyrore "Xhavit Ahmeti" | 40 |
| 2. Gjinnazi i Shkencave Shoqërore "Zenel Hajdini" | 47 |
| 3. Shkolla e Mesme Ekonomike "Marin Barleti" | 54 |
| 4. Shkolla e Mesme Teknike "Mehmet Isai" | 61 |
| 5. Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria" | 68 |
| DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET | 76 |
| Kufizimet e studimet | 77 |
| Hulumtimet në të ardhmen | 77 |
| Implikimet praktike nga studimi | 78 |
| REFERENCAT BIOBLOGRAFIKE | 79 |
| SHTOJCA A: LEJA NGA DKA - GJILAN | 84 |
| SHTOJCA B: LEJET NGA SHKOLLAT | 85 |
| SHTOJCA C: TË DHËNAT | 90 |

Lista e tabelave

| | |
|---|----|
| Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve. | 17 |
| Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas paraleleve. | 18 |
| Tabela 3. Suksesi gjatë shkollimit të mesëm në lëndën e matematikës. | 20 |
| Tabela 4. Rezultati në provimin e maturës në matematikë. | 20 |
| Tabela 5. Frekuenca e pikëve për nxënësit me sukses të mjaftueshëm. | 23 |
| Tabela 6. Frekuenca e pikëve për nxënësit me sukses të mirë. | 24 |
| Tabela 7. Frekuenca e pikëve për nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm. | 25 |
| Tabela 8. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicionin relativ. | 26 |
| Tabela 9. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit me sukses të mjaftueshëm. | 29 |
| Tabela 10. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit me sukses të mirë. | 30 |
| Tabela 11. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm. | 31 |
| Tabela 12. Analiza e korrelacionit të variablave. | 39 |
| Tabela 13. Frekuenca e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”. | 41 |
| Tabela 14. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicionin relativ i pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”. | 42 |
| Tabela 15. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”. | 44 |

| | |
|---|----|
| Tabela 16. Frekuenca e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”..... | 48 |
| Tabela 17. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicioni relativ i pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”. | 49 |
| Tabela 18. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”..... | 51 |
| Tabela 19. Frekuenca e pikëve për nxënësit e Shkollës e Mesme Ekonomike "Marin Barleti"... | 55 |
| Tabela 20. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicionin relativ i pikëve për nxënësit e Shkollës e Mesme Ekonomike "Marin Barleti". | 56 |
| Tabela 21. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit e Shkollës e Mesme Ekonomike "Marin Barleti". | 58 |
| Tabela 22. Frekuenca e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 62 |
| Tabela 23. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicionin relativ i pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 63 |
| Tabela 24. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 65 |
| Tabela 25. Frekuenca e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 69 |
| Tabela 26. Masat e vendodhjes qendrore, masat e ndryshueshmërisë dhe pozicionin relativ i pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 70 |
| Tabela 27. Z Rezultatet e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 72 |

Lista e figurave

| | |
|---|----|
| Figura 1. Kategorizimi i të dhënave..... | 22 |
| Figura 2. Grafiku kuti i pikëve për nxënësit me sukses të mjaftueshëm. | 27 |
| Figura 3. Grafiku kuti i pikëve për nxënësit me sukses të mirë..... | 28 |
| Figura 4. Grafiku kuti i pikëve për nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm. | 28 |
| Figura 5. Shpërndarja e pikëve për nxënësit me sukses të mjaftueshëm. | 32 |
| Figura 6. Shpërndarja e pikëve për nxënësit me sukses të mirë. | 33 |
| Figura 7. Shpërndarja e pikëve për nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm. | 34 |
| Figura 8. Paraqitja grafike e të dhënave..... | 35 |
| Figura 9. Kategorizimi i suksesit për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”..... | 40 |
| Figura 10. Grafiku kuti për pikët e nxënësve e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”..... | 43 |
| Figura 11. Shpërndarja e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Natyrore “Xhavit Ahmeti”..... | 45 |
| Figura 12. Kategorizimi i suksesit për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”..... | 47 |
| Figura 13. Grafiku kuti për pikët e nxënësve e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”..... | 50 |
| Figura 14. Shpërndarja e pikëve për nxënësit e Gjimanzit të Shkencave Shoqërore “Zenel Hajdini”..... | 52 |

| | |
|--|----|
| Figura 15. Kategorizimi i suksesit për nxënësit e Shkollës e Mesme Ekonomike "Marin Barleti". | 54 |
| Figura 16. Grafiku kuti për pikët e nxënësve të Shkollës së Mesme Ekonomike "Marin Barleti". | 57 |
| Figura 17. Shpërndarja e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme Ekonomike "Marin Barleti". | 59 |
| Figura 18. Kategorizimi i suksesit për nxënësit e Shkollës e Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 61 |
| Figura 19. Grafiku kuti për pikët e nxënësve të Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 64 |
| Figura 20. Shpërndarja e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai". | 66 |
| Figura 21. Kategorizimi i suksesit për nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 68 |
| Figura 22. Grafiku kuti për pikët e nxënësve të Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 71 |
| Figura 23. Shpërndarja e pikëve për nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria". | 73 |

HYRJE

Për të matur nivelin e arritjeve të nxënësve gjatë shkollimit përdoren teste në fund të secilit nivel të arsimit parauniversitar, të cilat janë të mandatuara nga jashtë. I tillë është edhe provimi i maturës shtetërore i cili është i organizuar dhe i mbikëqyrur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës. Meqë ky provim vlerëson se sa kanë nxënë nxënësit gjatë shkollimit të mesëm, atëherë kjo gjë i shqetëson mësimdhënësit e këtyre nxënësve sepse këto rezultate i konsiderojnë si pasqyrë të punës së tyre. Për këtë arsye ata gjithnjë e më shumë janë të angazhuar për t'i përgaditur nxënësit për këtë provim, në mënyrë që rezultatet të jenë të kënaqshme, jo vetëm për nxënësit por edhe për mësimdhënësit. Kjo gjë edhe pse mund të sjellë rezultatet pozitive bënë që nxënësit të mos mësojnë në mënyrë logjike zgjidhjen e detyrave por vetëm të memorizojnë hapat se si arrihet deri te rezultati.

Megjithatë na ndodh shpesh që të ndëgjojmë që nxënësit e shkëlqyeshëm të mos arrijnë rezultate shumë të mira në provimin e maturës shtetërore. Kjo ndoshta ndodhë sepse vlerësimi gjatë shkollimit që përfshin vlerësimin formativ dhe sumativ bëjnë që nxënësit të vlerësohen gjatë orëve mësimore me anë të përgjigjeve që japin në klasë, aktiviteteve, hulumtimeve të ndryshme, si dhe me anë të testeve përmbledhëse në fund të periodave. Ky lloj i vlerësimit shpesh bënë që nota në fund të vitit të mos jetë pikërisht nota që marrin nxënësit në testin përmbledhës. Për dallim nga notat që nxënësit e marrin gjatë shkollimit, Provimi i Maturës Shtetërore është vlerësim që kryhet vetëm me anë të një testi.

Në lëndën e matematikës përveq zgjidhjes së detyrave shpesh gjatë orëve mësimore kërkohet nga nxënësit që të argumentojnë dhe arsyetojnë zgjidhjen. Kjo gjë nuk është e mundur në provimin e maturës sepse struktura e këtij testi kërkon që të rrumbullaksohet vetëm një përgjigje e saktë, pra kërkohet nga nxënësit që të gjendet vetëm një zgjidhje dhe nuk merret parasysh mënyra e zgjidhjes apo nuk kërkohen sqarime shtesë për mënyrën se si është arritur deri te ai rezultat. Prandaj edhe 1 gabim i vogël teknik gjatë mbledhjes, zbritjes, shumëzimit apo pjestimit ndikon që rezultati të mos jetë i saktë, edhe pse nxënësi e dinë mënyrën e zgjidhjes së asaj detyre. Mirëpo këto gabime mund të bëhen te një numër i vogël i detyrave dhe përveq që

mund të ndikojnë në zvogëlimin e rezultatit për një numër të vogël të pikëve nuk mund të kenë një ndikim të madh në rezultatin e përgjithshëm.

Gjithashtu një problem tjetër që e ndëgjojmë nga nxënësit është edhe plotësimi i fletës së rezultateve, e cila lexohet në mënyrë automatike nga një paisje kompjuterike. Këto fleta nuk duhet që të fshihen me gomë apo me ndonjë gjë tjetër sepse pastaj kur lexohen e marrin si të pa saktë përgjigjen që është ndryshuar. Kjo gjë ndikon që nxënësit të mos mund të korigjojnë asnjë përgjigje, qoftë për arsye sepse kanë gabuar në përgjigjen e parë apo sepse kanë gabuar numrin e detyrës gjatë plotësimit të kësaj flete. Edhe pse gabime të tilla ndodhin ato janë në numër të vogël për totalin e nxënësve që i nënshtrohen këtij testi saqë nuk kanë ndonjë ndikim të madh në rezultatin e tërësishëm në nivel shkolle apo komune.

Rezultati i provimit të maturës është pikë kyqe për zhvillimin profesional të nxënësve sepse përveq që nxënësit nuk mund të fillojnë studimet në rast se nuk arrijnë të kalojnë pragun minimal të vendosur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë për këtë provim, por edhe sepse pikët e lëndëve të caktuara luajnë një rol shumë të rëndësishëm në orientimin profesional të tyre. Veqanërisht matematika është një lëndë që ka një zbatim të madh pothuajse në secilën lëmi prandaj edhe kërkohet nga drejtime të ndryshe universitare që rezultatet e kësaj lënde në provimin e maturës të jenë të larta, në mënyrë që nxënësit të mund të studiojnë atë drejtim.

Reagimet e mësimdhënësve për rezultatet e nxënësve në provimin e maturës në lëndën e matematikës dhe në veqanti nga zhgënjimi që kanë nga nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm, kanë qenë shtysë për të bërë një analizë krahasuese ndërmjet suksesit të nxënësve gjatë shkollimit dhe pikëve në provimin e maturës shtetërore në lëndën e matematikës, për të parë nëse janë disa raste të veqanta këto që diskutohen apo ndodhë në përgjithësi ky rezultat në provimin e maturës. Ky hulumtimi është kryer në 5 shkolla të mesme të komunës së Gjilanit.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj dallimin mes suksesit të nxënësve në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm dhe pikëve që ata marrin në provimin e maturës në matematikë.

Pyetja e hulumtimit dhe hipoteza

P: Sa ndikon suksezi që kanë nxënësit gjatë shkollimit të mesëm në lëndën e matematikës në pikët që ata marrin në provimin e maturës në matematikë?

H: Pikët që i arrijnë nxënësit në provimin e maturës në matematikë varen ekskluzivisht nga suksezi që kanë në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Qëllimi i vlerësimit

Vlerësimi është përdorur për qëllime të shumëfishta, të tilla si: udhëzimet, për vlerësim formues, diagnostifikim, kualifikim, licencim, zgjedhjen e shkollës, për vlerësim të programit, monitorim të studentëve, institucioneve dhe sistemit (Newton, 2007).

Me Kornizën e Kurrikulës së Republikës së Kosovës përcaktohen qëllimet, parimet, dhe llojet e vlerësimit që sigurojnë ndërlidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit. Sistemi i vlerësimit definon se çka vlerësohet, kur vlerësohet, si dhe nga kush realizohen llojet e ndryshme të vlerësimit të nxënësve. Qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënit të nxënësve. Përmes sistemit të vlerësimit të nxënësve kërkohet të sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit, përshtatshmërinë e kurrikulës dhe përmirësimin e shkollës. Mbi bazën e këtyre informacioneve merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të vlerësimit në përgjithësi (MASHT, 2016).

“Si dhe çfarë vlerësojmë, jep një tregues të qartë të asaj që vlerësojmë dhe drejton atë se çfarë dhe si mësojnë studentët.” (Van De Watering, Gijbels, Dochy, & Van De Rijt, 2008, p. 186). Qëllimi kryesor i vlerësimit në arsimin e matematikës është të sigurojë prova që përdoren për të marrë vendime për të përmirësuar arsimin matematikor, i cili më pas ngre pyetje se cilat aspekte të kompetencës matematikore duhet të vlerësohen si dhe për çfarë qëllimi (Nortvedt & Buchholtz, 2018).

Llojet e vlerësimit

Korniza Kurrikulare e Republikës së Kosovës përcakton dy lloje të vlerësimit:

1. Vlerësimi i brendshëm

Bëhet në nivel shkolle/klase nga mësimdhënësit e shkollës. Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e të nxëniet të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit formativ (për nxënie) dhe vlerësimit përmbledhës (i të nxëniet) (MASHT, 2016).

"Vlerësimi për nxënie (vlerësimi formues) është pjesë e praktikës së përditshme për studentët, mësuesit dhe kolegët që kërkon, reflekton dhe i përgjigjet informacionit nga dialogu, demonstrimi dhe vëzhgimi në mënyra që përmirësojnë të mësuarit në vazhdim" (Klenowski, 2009). Ky lloj vlerësimi në nivel klase përfshinë një gamë të gjerë vlerësimesh (zakonisht) të zgjedhura ose të bëra nga mësuesit, dhe është e lidhur ngushtë me të mësuarit e drejtpërdrejtë të studentëve përmes reagimeve dhe mekanizmave të tjerë (Baird, Hopfenbeck, Newton, & Stobard, 2014). "Një vlerësim funksionon në mënyrë formuese në atë mënyrë që faktet në lidhje me arritjet e nxënësve nxirren, interpretohen dhe përdoren nga mësuesit, nxënësit ose kolegët e tyre, për të marrë vendime në lidhje me hapat e ardhshëm të udhëzimeve që ka të ngjarë të jenë më të mira, ose të bazuara më mirë, sesa vendimet që ata do të kishin marrë në mungesë të këtyre fakteve." (Black & Wiliam, 2009),² siç citohet në (Wiliam D. , 2011b, p. 11). Vlerësimi në klasë mund të bëhet nga mësuesi, bashkëmoshatarët ose nxënësit për vetveten. Në këtë mënyrë vetëvlerësimi i referohet të gjitha proceseve nëpër të cilat kalojnë nxënësit në mënyrë që të identifikojnë ose diagnostikojnë vetë përparimin e tyre të të nxëniet. Përdorimi i vetëvlerësimit sjell përparësi në klasë duke rritur përgjegjësinë e studentëve për procesin e tyre të të mësuarit, si dhe për performancën akademike duke përdorur proceset metakognitive si dhe rritjen e motivimit dhe angazhimit në mësim (Brown & Harris, 2013).

Vlerësimi përmbledhës (i të nxëniet) zakonisht zbatohen në fund të një periudhe mësimore për të matur rezultatin e të mësuarit të studentëve. Përdoret për të nxitur përmirësimin e kursit,

për të vlerësuar efektivitetin e mësimdhënies dhe për vlerësime të nivelit të programit (Kibble, 2017). Ndryshe nga vlerësimi formuese, i cili zakonisht përdoren për sigurimin e informatave kthyesë për studentët dhe mësuesit, vlerësimet përmbledhëse përdoren për të marrë një vlerësim përfundimtar se sa mësim është nxënë - domethënë, sa di një student (Gardner J. , 2010). Përveç rolit të tij në përcaktimin e nivelit të suksesit ose aftësisë së një studenti në një kohë të caktuar, vlerësimi përmbledhëse përdoret gjithashtu për të përcaktuar të drejtën për programe të veçanta, për të vlerësuar nëse një student duhet të kalojë në klasën tjetër, për të siguruar udhëzime në karrierë (Harlen & Gardner, 2010).

Vlerësimi informon mësuesit për hapat e ardhshëm që duhet të ndërmarrin në klasë apo për veprime më efektive në të ardhmen, pasi ndihmon në zhvillimin e "një koleksioni veprimesh alternative (ndaj reagimeve të zakonshme) dhe një vetëdije për situatat në të cilat këto veprime do të ishin të preferueshme" (Mason, 2011). Kjo do të thotë që interpretimet dhe veprimet e mësuesit kontribuojnë në proceset e vlerësimit dhe mund të shërbejnë për vlerësim formuese, përmbledhëse ose të dy llojeve të vlerësimit. Edhe pse mësuesit ishin dhe vazhdojnë të jenë nën presion të madh për t'i bërë studentët e tyre të arrijnë rezultate të larta, këto rezultatet të të gjitha llojeve të vlerësimit duhet të përmbushin standardet minimale të besueshmërisë dhe vlefshmërisë (American Educational Research Association, 2014).

2. Vlerësimi i jashtëm

Është vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit, zotërimin e kompetencave në fund të nivelit I, II dhe III të arsimit parauniversitar. Ky vlerësim organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për disa qëllime si:

- inspektim dhe verifikim i cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle dhe komune,
- hulumtim dhe zhvillimi,

- vendimmarrje në politikë-bërje në fusha të ndryshme të arsimit (MASHT, 2016).

Vlerësimet në shkallë të gjerë jo vetëm që shërbejnë si mjete për raportimin e arritjeve të studentëve, por sigurojnë objektiva të vlefshëm për t'i ndjekur mësimdhënësit dhe studentët (De Lange, 2007). Ky vlerësim duhet të jetë i aftë të sigurojë informacione për përdorim nga mësuesit si dhe për të bërë analiza përmbledhëse të sistemit të arsimit. Është ideale që vlerësimi në shkallë të gjerë të kontribuoj në mësimin e studentëve sesa thjesht të identifikoj gjendjen aktuale. Nëse studentët dhe mësuesit vlerësohen bazuar në rezultatet e vlerësimeve në shkallë të gjerë, veçanërisht në vendet me provime të maturës, ka nevojë që studentët të provojnë disa vlerësime në klasë që kanë të bëjnë me llojet e detyrave të përdorura në vlerësime të tilla (Care, Griffin, Zhang, & Hutchinson, 2014).

(Eurydice, 2011) zbuloi se testimi kombëtar i studentëve është një praktikë e përhapur në sistemet arsimore europiane. Rezultatet e testeve kombëtare përdoren për të dhënë certifikata, dhe/ose për të monitoruar dhe vlerësuar shkollat ose sistemin në tërësi. Testet kombëtare përdoren më rrallë për qëllime formuese, d.m.th., për të identifikuar nevojat specifike të nxënit të studentëve. Në disa vende këto teste kanë një numër të kufizuar të lëndëve kryesore të kurrikulës, por në vende të tjera përmbajnë një gamë më të gjerë testimi. Megjithatë matematika testohet edhe kur vlerësohen vetëm dy ose tre lëndë edhe pse fokusi i vlerësimit mund të ndryshojë, për shembull mund të bazohet në një përkufizim të gjerë të matematikës ose mund të përqendrohet në aftësitë thelbësore, ose mund të ketë një qasje më të zbatuar për sa i përket kompetencës matematikore. Në Republikën e Kosovës testi i provimit të maturës shtetërore 2021 kishte të njejtën strukturë sikurse ai i vitit 2020, pra përbëhej nga 4 lëndë, prej të cilave 3 janë obligative ku bënë pjesë edhe matematika, ndërsa 1 lëndë zgjedhore, të cilën e përzgjedhë vet kandidati (me rastin e paraqitjes së provimit të maturës) në mesin e lëndëve zgjedhore të ofruara në dispozicion. Ky test ka patur gjithsej 100 kërkesa (pyetje, detyra), ku 25 prej tyre janë nga lënda e matematikës (MASHTI, 2020). Looney shprehet se “rezultatet e disa testeve kombëtare duhet të përqendrojnë vëmendjen e mësuesve në standardet dhe përparësitë arsimore, por ato gjithashtu mund të minojnë qasjet inovative të mësimdhënies, përfshirë vlerësimin formues”. Ka fakte që mësuesit kanë më shumë gjasa të "japin mësim për testim" kur vlerësimet perceptohen se kanë nivele të larta (Looney A. , 2009, p. 5).

Ndikimi i vlerësimit të brendshëm në vlerësimin e jashtëm

Vetëm një test nuk mund të vlerësojë në mënyrë adekuate natyrën komplekse të të menduarit matematikor të studentëve. Përkundrazi, kërkohen lloje të ndryshme vlerësimi për të vlerësuar procese komplekse siç janë: zgjidhja e problemeve, arsyetimi ose prova e zgjidhjeve, ose lidhja e përfaqësimeve matematikore, prandaj mësuesit inkurajohen të përdorin një shumëllojshmëri të formave për vlerësim. “Një detyrë e performancës është çdo veprimtari ose vlerësim i të nxënit që u kërkon studentëve të kryejnë për të demonstruar njohuritë, kuptimin dhe aftësinë e tyre ”siç përcaktohet nga (McTighe, 2015). Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit është treguar se u siguron atyre një kuptim më të fortë të asaj që vlerësohet, megjithatë shumë pak i kushtohet vëmendje asaj që studentët e konsiderojnë të rëndësishëm ose të dobishëm në procesin e vlerësimit. Kryesisht është mësuesi ai që vendos për çfarë qëllimi do të përdoret përfshirja e studentit në vlerësim (Tillema, 2014).

Një theks të fortë të vlerësimit në klasë e ka vlerësimi formues dhe dëshira e mësuesve për të dhënë kuptim asaj që studentët po mendojnë dhe po mësojnë (Suurtamm & Neubrand, 2015). Vlerësimi i performancës në klasë duhet të sigurojë reagime formuese për nxënësin dhe mësuesin që të ndihmojë në drejtimin e studimit në të ardhmen. Parashikueshmëria e një testi do të përcaktojë nëse mesimdhënësi përqendrohet në të mësuarit e thellë apo sipërfaqësor. Mësuesit shpesh përpiqen të kategorizojnë dhe parashikojnë se cilat lloje të pyetjeve do të shfaqen në provim dhe i trajtojnë studentët t’i njohin këto lloje pyetje, megjithatë aftësia për të trajtuar probleme të panjohura është thelbi i "zgjidhjes së problemeve". Si vëzhgimi joformal (p.sh. me detyra të ndërtuara mirë) ashtu edhe hulumtimi kanë treguar se vlerësimi i hartuar mirë mund të jetë një levë unike e fuqishme e përmirësimit në shkallë të gjerë (Swan & Burkhardt, 2012). Gjithashtu, një element i rëndësishëm për të mësuar matematikën është fleksibiliteti. Fleksibiliteti në zgjidhjen e ekuacioneve lineare parashikon suksesin në provimin e maturës, kjo për faktin që nëse marrim dy studentë që janë njësoj të mirë në kryerjen e hapave teknik për zgjidhjen e një detyre, ata dy do të marrin rezultate të ndryshme mbi saktësinë e zgjidhjes nëse njëri përdor zgjidhjen inovative dhe tjetri përdor zgjidhjen standarde, sepse studentët që përdorin

strategjinë inovative kryejnë hapa më pak dhe më pak kompleksë për të arritur në përgjigje sesa studentët që përdorin zgjidhjen standarde (Hasto, Palkki, Tuomela, & Star, 2019).

Megjithatë duhet të kuptojmë se në çfarë mënyrash mund të zhvillojmë lidhje të drejtpërdrejta me atë që ndodh në klasa dhe çfarë matet në vlerësime në shkallë të gjerë duke krijuar një qasje zhvillimore për të mësuarit e matematikës së studentëve dhe duke i lidhur vlerësimet në mënyrë të qartë në vazhdimësi (Paek, 2012). Nëse mësuesit nuk kujdesen për mirëkuptimin e thellë dhe në vend të kësaj dëshirojnë vetëm të rrisin rezultatet e testeve të studentëve të tyre, atëherë vëmendja për vlerësimin formues duket të jetë një nga, në mos mënyra më e fuqishme për ta bërë këtë. Të mësuarit me cilësi çon në arritje më të larta, edhe kur performanca matet përmes testeve të mandatuara nga jashtë (Wiliam D. , 2007). Në një sërë mjedisesh mësuesit kanë zbuluar se duke dhënë mësim për të kuptuarit e thellë ka rezultuar në një rritje të performancës së studentëve në testet dhe provimet e bëra nga jashtë (Wiliam, Lee, Harrison, & Black, 2004). Ata duhet të përdorin vlerësimin për të mbështetur të mësuarit e studentëve, me anë të një game të gjerë metodash për të marrë një kuptim të të kuptuarit të studentëve, përmes tre mënyrave specifike : duke u siguruar studentëve reagime mbi mendimin e tyre matematikor, duke zhvilluar aftësinë e studentëve për të vetëvlerësuar dhe vepruar mbi informacionin e vlerësimit, dhe duke u siguruar mësuesve informacione për të udhëhequr praktikën e tyre në klasë (Suurtamm, Koch, & Arden, 2010).

Procesi i vlerësimit është mekanizmi që kryen një gjykim. Duke e bërë të qartë procesin e vlerësimit, është e mundur të rivlerësohet vlerësimi për proceset e të nxënit. Duke u përqëndruar në proceset e vlerësimit në krahasim me funksionet e vlerësimit, nga njëra anë është më e lehtë të jesh i qartë në procedurat dhe, rrjedhimisht, t'i përmirësosh ato, dhe nga ana tjetër, të harmonizosh teorinë e vlerësimit formues në mënyrë më të përshtatshme me praktikën (Tara, 2009).

Ndikimi i vlerësimit të jashtëm në vlerësimin e brendshëm

Korniza Kurikulare përcakton tri vlerësime të standardizuara shtetërore në fund të niveleve formale të arsimit të cilat realizohen për qëllime të ndryshme:

- Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V,
- Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX,
- Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII - Provimi i Maturës Shtetërore (MASHT, 2016).

Provimi i Maturës Shtetërore është vlerësim i njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve të cilat i kanë arritur gjatë arsimit parauniversitar në përputhje me Kornizën Kurikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (MASH, 2020). Struktura e Provimit të Maturës në vitin 2021 ka qenë e njëjtë sikurse ajo e vitit 2020, ku për çdo kërkesë (pyetje, detyrë) në provim ofrohen 4 mundësi/alternativa të përgjigjeve, prej të cilave vetëm njëra është e saktë (MASHTI, 2020). Ky format me shumë zgjedhje shpesh inkurajon studentët të provojnë të gjitha përgjigjet e ofruara për ta gjetur zgjidhjen se sa ta zgjidhin atë problem në të vërtetë (Seeley, 2006). Hartuesit e testit duhet të mendojnë se si të testojnë një koncept në të gjithë harkun e të kuptuarit të tij. Kjo nuk është një detyrë e thjeshtë, mirëpo duhen diskutuar sa më shumë që është e mundur mendime të ndryshme kur përpilojnë planet e vlerësimit, në varësi të qëllimit të vlerësimit (Paek, 2012). Thelbi i hartimit të provimit është krijimi i detyrave të përshtatshme. Sidoqoftë, duhet të merren parasysh qëllimet e ndryshme për të cilat janë ndërtuar testet. Prandaj, detyrat dhe modeli i provimit duhet të kenë aspekte të natyrës konceptuale dhe praktike, dhe duhet të merren parasysh çështjet e zbatimit të tyre (Suurtamm & Neubrand, 2015). Në një studim të kryer nga Merki dhe Holmeier është analizuar efekti i zbatimit të provimit të maturës në 19 shkollat e mesme të larta në qytetin gjerman të Bremenit për 5 vjet. Me futjen e provimit të maturës në tërë shtetin, është rritur mesatarja e notave nëpër shkolla. Janë pikërisht notat semestrale për të cilat është vërejtur një ndryshim pozitiv. Përgjashtim bën semestri i dytë në

klasën e 12-të, sepse nuk tregohet ndonjë ndryshim i rëndësishëm midis viteve (Merki & Holmeier, 2015).

Përdorimi i të dhënave të vlerësimit për të marrë vendime udhëzuese trajtohet si joproblematik, sikur ekziston një lidhje e thjeshtë midis të kuptuarit të asaj që dinë studentët dhe se si ta përdorin këtë njohuri në udhëzime. Kalimi në hapin tjetër, për të ndihmuar mësuesit të mësojnë si të përdorin këto të dhëna vlerësimi për vendimmarrjen udhëzuese nuk është një detyrë e thjeshtë, por është thelbësore (Even, 2005). Reformat arsimore në mënyrë mjaft korrekte, zhvendosën fokusin e vëmendjes tek rezultatet arsimore, d.m.th. të mësuarit e nxënësve dhe performancës në shkollë. Si pasojë, një besim i pranuar gjerësisht - dhe përgjithësisht i padiskutueshëm - midis politikëbërësve dhe reformatoreve të arsimit është se vendosja e standardeve të qarta dhe mjaft të larta të performancës për shkollat, mësuesit dhe studentët do të përmirësojë domosdoshmërisht cilësinë e rezultateve të pritura. Zbatimi i sistemeve të testimit dhe vlerësimit të jashtëm për të vlerësuar se sa mirë janë arritur këto standarde, fillimisht nga politikat e arsimit të orientuara drejt standardeve. Që nga fundi i viteve 1980, kurrikulat e përshkruara në mënyrë qendrore, me synime të detajuara dhe shpesh ambicioze të performancës, teste të shpeshta të studentëve dhe mësuesve, dhe përgjegjësi e bazuar në prova kanë karakterizuar një homogjenizim të politikave arsimore në të gjithë botën, duke premtuar zgjidhje të standardizuara me kosto gjithnjë e më të ulëta për ata që dëshirojnë të përmirësojnë shkollën, cilësinë dhe efektivitetin (Sahlberg, 2013, p. 1).

Ndërlidhja e vlerësimit në shkallë të gjerë dhe vlerësimit në klasë

Ekziston një tension midis vlerësimit në shkallë të gjerë dhe vlerësimit në klasë. Sidoqoftë, vlerësimi i jashtëm në shkallë të gjerë nuk ka nevojë të shihet krejtësisht ndryshe nga vlerësimi në klasë. Vlerësimi i jashtëm në shkallë të gjerë dhe vlerësimi i klasës në matematikë mund të lidhen për rritjen e të mësuarit të studentëve dhe përmirësimin e mësimdhënies në klasë

(Shimizu, 2011). (Wyatt-Smith, Klenowski, & Colbert, 2014, p. 2) sugjerojnë që "arsimimi më i mirë për të rinjtë është i arritshëm kur politika dhe praktika arsimore i japin përparësi përmirësimit të të mësuarit, duke bërë kështu vlerësimin e përgjegjësive një shqetësim të lidhur, edhe pse dytësor".

Nuk ka dyshim se shumë mund të mësohet nga vlerësimi në shkallë të gjerë. Vlerësimet ndihmojnë për të nxjerrë në pah boshllëqet e arritjeve, tregojnë fushat ku mund të kërkohen përshtatje ndaj udhëzimeve dhe mund të çojnë në reforma në kurrikulë (Suurtamm, et al., 2016). Këto reforma ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e mësimitdhënësve. Tradicionalisht, informacioni i vlerësimit shihet vetëm në lidhje me studentët, aftësitë e tyre, ato që dinë dhe nuk dinë. Ndryshimi që nevojitet është të mendosh për informacionin e vlerësimit që pasqyron efektivitetin e mësimitdhënies; sa mirë është mësuar ose nuk është mësuar një koncept i veçantë dhe çfarë është ajo që mësuesit duhet të mësojnë që studentët të jenë më të suksesshëm. Mësuesit duhet të ndihmohen për t'u përfshirë në praktikën e vlerësimit që përfshijnë cikle kërkimore dhe ndërtimin e njohurive që kanë si fokus përmirësimin e rezultateve për studentët (Timperley, 2014). (Suurtamm & Koch, 2014) përshkruajnë llojet e dilemave me të cilat përballen mësuesit në ndryshimin e praktikave të vlerësimit duke përdorur kornizën e Windschitll të katër kategorive të dilemave - konceptuale, pedagogjike, politike dhe kulturore - për të analizuar transkriptimet e tyre.

- Dilemat konceptuale lindin ndërsa mësuesit përpiqen të kuptojnë bazat konceptuale të mësimitdhënies dhe të nxëniet të matematikës të bazuar në kërkime dhe të pikëpamjeve aktuale të vlerësimit.
- Dilemat pedagogjike lindin ndërsa mësuesit merren me "mënyrën" të miratimit të ideve aktuale të vlerësimit.
- Dilemat kulturore lindin kur praktikën e reja të vlerësimit kërcënojnë praktikën ekzistuese kulturore.
- Dilemat politike shfaqen kur mësuesit luftojnë me politikën të veçanta kombëtare, shtetërore, provinciale, rrethi ose shkollorë në lidhje me vlerësimin.

Duke pasur parasysh parimet e hartimit të vlerësimit në modelin e zhvillimit profesional, i cili u krijua për të përmirësuar vlerësimin në klasë të mësuesve në matematikën e klasave të mesme, tregon që shumica e mësuesve u angazhuan në planifikimin dhe hartimin e vlerësimit në një mënyrë që kishte më shumë të ngjarë të rriste qasjen e studentëve në matematikë përmes mbështetjes kontekstuale dhe të sigurote më shumë mundësi për studentët që të angazhohen në arsyetime përtej rikujtimit të procedurave, rregullave dhe fakteve (Webb, 2012).

Megjithatë nuk duhet të ndahet vlerësimi i brendshëm nga vlerësimi i jashtëm pasi është shumë e rëndësishme që këto dy lloje të vlerësimit të ndajnë çështjet, idetë dhe praktikatat e tyre për të parë nëse ekziston një harmonizim midis vlerësimit që po vazhdon apo vlerësimit në klasë dhe vlerësimit që është një ngjarje apo vlerësimit në shkallë të gjerë (Suurtamm & Neubrand, 2015). Procesi i vlerësimit në kontekstin e përdorimit të shumëfishtë të tij kërkon një bashkëpunim të shtuar midis zhvilluesve të vlerësimit dhe përdoruesve. As zhvilluesit e vlerësimit dhe as mësuesit që përdorin vlerësimin në klasë nuk janë në gjendje të mbledhin provat e nevojshme për të kuptuar ndërveprimet komplekse që ndodhin midis këtyre dy përdorimeve. Këta individë dhe grupe do të duhet të bashkëpunojnë dhe të ndajnë informacionin për të kuptuar implikimet në procesin e vlerësimit. Pavarësisht nëse flasim për vlerësim në shkallë të gjerë ose në klasë, vëmendja duhet t'i kushtohet qëllimit të vlerësimit, në mënyrë që rezultatet e vlerësimit të interpretohen dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme për atë qëllim (Koch, 2013). Roli i vlerësimit si një nga drejtuesit kryesorë të reformës në arsim është pranuar gjerësisht nga udhëheqësit e sistemit, akademikë dhe studiues. Vlerësimi tani është pjesë e diskursit global mbi reformën në arsim dhe roli i tij në ndikimin e ndryshimeve zakonisht shihet si 'lajm mirë'. Merrni vlerësimin si duhet, dhe gjithçka tjetër bie në vend (Looney A. , 2014).

METODOLOGJIA

Në këtë temë fillimisht është bërë shqyrtimi i literaturës, në mënyrë që të shikohen të gjeturat nga hulumtues të ndryshëm me fokus në vlerësimin e nxënësve, qoftë ai vlerësim i brendshëm apo i jashtëm, dhe veqanërisht për vlerësimin në lëndën e matematikës.

Duke u bazuar që qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj dallimin mes suksesit të nxënësve në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm dhe pikëve që ata marrin në provimin e maturës në matematikë, ka qenë e nevojshme që të mbledhen të dhëna sasiore, gjë që tregon që edhe hulumtimi i kryer është sasiore. Më saktësisht është përdorur modeli jo-eksperimental korrelativ, meqë pyetja e hulumtimit përqendrohet në marrëdhënien statistikore midis dy variablave por nuk përfshin manipulimin e ndryshores së pavarur. Ndërsa për t'i analizuar ato janë përdorur metoda statistikore, matematikore ose llogaritëse.

Ky hulumtim është kryer në 5 shkolla të mesme të komunës së Gjilanit, më saktësisht në: Gjimnazin e Shkencave Shoqërore "Zenel Hajdini", Gjimnazin e Shkencave Natyrore " Xhavit Ahmeti ", Shkollën e Mesme Ekonomike "Marin Barleti", Shkollën e Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria" dhe Shkollën e Mesme Teknike "Mehmet Isai".

Mostra

Grupin e studimit në këtë hulumtim e përbëjnë 339 maturant të viti 2021, të cilët janë nga komuna e Gjilanit. Lloji i mostrës që është përdorur është grupor në mënyrë që të merren të dhëna nga maturant me orientime të ndryshme profesionale. Në mënyrë që të analizohen rezultatet për secilën shkollën në veqanti dhe për të parë ndryshimet e këtyre rezultateve për shkolla të ndryshme, nga secila shkollë janë zgjedhur 3 klasë për hulumtim me anë të përzgjedhjes së thjeshtë të mostrës së rastësishme. Fakti që të dhënat janë marrë për maturantët

që sapo kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë tregon që mosha e popullacionit është mesatarisht 18 vjeç.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur karakteristikat përshkruese të mostrës, si: shkolla se ku e kanë kryer shkollimin e mesëm pjesëmarrësit e këtij hulumtimi, numri i pjesëmarrësve prej secilës shkollë si dhe në cilën paralele kanë qenë.

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve.

| Shkollat | N | Paralelja | | |
|--|------------|-----------|-----|------|
| | | I | III | V |
| Gjimnazi i Shkencave Natyrore " Xhavit Ahmeti " | 93 | I | III | V |
| Gjimnazi i Shkencave Shoqërore "Zenel Hajdini" | 92 | I | IV | VIII |
| Shkolla e Mesme Ekonomike "Marin Barleti" | 56 | I | II | III |
| Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria" | 43 | II | IV | VI |
| Shkolla e Mesme Teknike "Mehmet Isai" | 55 | IV | VII | XI |
| Total | 339 | | | |

Pastaj në Tabelën 2 është paraqitur shpërndarja e mostrës sipas paraleleve apo sa ka qenë numri i pjesëmarrësve në secilën klasë që janë bërë pjesë e këtij hulumtim.

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas paraleleve.

| Shkollat | | | | | Total |
|--|----------------|----|-----|-----|--------------|
| Gjimnazi i Shkencave Natyrore " Xhavit Ahmeti " | Paralelja | I | III | V | |
| | Nr. i nxënësve | 30 | 32 | 31 | 93 |
| Gjimnazi i Shkencave Shoqërore "Zenel Hajdini" | Paralelja | I | IV | VII | |
| | Nr. i nxënësve | 32 | 29 | 31 | 92 |
| Shkolla e Mesme Ekonomike "Marin Barleti" | Paralelja | I | II | III | |
| | Nr. i nxënësve | 20 | 17 | 19 | 56 |
| Shkolla e Mesme e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Arbëria" | Paralelja | II | IV | VI | |
| | Nr. i nxënësve | 14 | 15 | 14 | 43 |
| Shkolla e Mesme Teknike "Mehmet Isai" | Paralelja | IV | VII | XI | |
| | Nr. i nxënësve | 17 | 17 | 21 | 55 |
| Total | | | | | 339 |

Instrumentet

Të dhëna që janë mbledhur për t'i dhënë përgjigje pyetjes së hulumtimit janë:

1. Notat e nxënësve në matematikë gjatë shkollimit të mesëm (për 3 vite) dhe
2. Pikët në provimin e maturës shtetërore në lëndën e matematikës (Shtojca C).

Notat e nxënësve janë marrë në regjistrat apo ditarët që gjenden nëpër shkolla dhe pikët në provimin e maturës në lëndën e matematikës janë marrë në raportin e pikëve të testit të maturës që e ka secila shkollë.

Procedurat

Në mënyrë që të kemi qasje në të dhënat që nevojiten, fillimisht është kërkuar leje për realizimin e këtij hulumtimi në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjilan (Shtojca A) dhe pastaj tek drejtorët e shkollave (Shtojca B) duke premtuar që do të ruhet konfidencialiteti i secilit maturant që do të bëhet pjesë e hulumtimit. Pas marrjes së lejeve jemi drejtuar tek personi përgjegjës (sekretari) për arkivën apo regjistrat e shkollës që përmbajnë informacione për notat dhe pikët në provimin e maturës.

Pasi janë siguruar këto të dhëna fillimisht janë koduar si në vijim:

1. Nga notat e nxënësve në lëndën e matematikës gjatë shkollimit të mesëm është gjetur mesatarja e secilit prej tyre, pastaj në bazë të mesatares janë ndarë në 3 kategori: nxënësit me sukses të mjaftueshëm, me sukses të mirë dhe nxënësit me sukses të shkelqyeshëm, të cilat janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3. Suksesi gjatë shkollimit të mesëm në lëndën e matematikës.

